

RELACION

PËR

PROJEKTIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR REHABILITIMIN E LINJËS HEKURUDHORE VORË-HANI I HOTIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për rehabilitimin e linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit, nëpërmjet së cilës do të akordohet një hua, në vlerën prej 98 750 000 eurosh.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit për të mundësuar ofrimin e një shërbimi modern të transportit, arritjen e lëvizshmërisë së gjelbër të qëndrueshme, sipas standardeve të BE-së, si dhe zbatimin e direktivave të BE-së e përmbushjen e kërkesave të financuesve. Projekti do të kontribuojë në rritjen e ndjeshme të lëvizjes hekurudhore të mallrave dhe pasagjerëve, që hyjnë e dalin nga Shqipëria nëpërmjet zgjatimit të rrjetit bazë TEN-T, që mbërrin në Portin e Durrësit ose që del nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Si pjesë e agjendës së ndërlidhjes, projekti synon të lidhë nëpërmjet hekurudhës Shqipërinë me Malin e Zi nëpërmjet stacionit të përbashkët hekurudhor të Tuzit drejt Podgoricës e më tej, drejt lidhjeve hekurudhore ndërkombëtare midis kryeqyteteve, duke përfshirë përveç Tiranës dhe Podgoricën e Beogradin, Zagrebin, Lubjanën dhe Budapestin e do të japë një shtysë në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten në Këshillin e Ministrave, për vitin 2024.

Ndërkohë, evidentojmë se projekti është pjesë e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare (NSPP), miratuar me vendimin nr.161, datë 20.3.2024, të

Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2025-2027”.

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, ku një ndër qëllimet strategjike është edhe zbatimi i investimeve që lidhen me përmirësimin e aksesit në pikat hyrësdalëse tokësore, përmirësimin e korridoreve rrugore, ndërtimin e porteve, ndërtimin e aeroporteve, ndërtimin e hekurudhave, stacioneve multimodale etj.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë viteve të fundit ka vijuar procesi për transformimin e sektorit hekurudhor, duke krijuar parakushtet e nevojshme për krijimin e një tregu të hapur për investorët publikë dhe privatë, si në aspektin e rregullimit të tregut, edhe në atë të menaxhimit të infrastrukturës apo operacioneve hekurudhore.

Është miratuar paketa ligjore në zbatim të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht me këtë kanë filluar investimet në infrastrukturën hekurudhore.

Paralelisht me Agjendën e Gjelbër të BE-së, të datës 6.10.2020, Komisioni Evropian miratoi planin gjithëpërfshirës ekonomik dhe të investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë ekonomike të rajonit të Ballkanit Perëndimor, të mbështesë një tranzicion të gjelbër dhe digjital, të nxisë integrimin rajonal dhe me Bashkimin Evropian.

Në fushën e transportit hekurudhor Komisioni Evropian ka përfshirë në këtë plan projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, deri në kufi me Malin e Zi, duke lidhur kryeqytetet e Tiranës e Podgoricës dhe me shtrirje deri në Portin e Durrësit.

Projekti do të kontribuojë në rritjen e ndjeshme të lëvizjes hekurudhore të mallrave dhe pasagjerëve që hyjnë dhe dalin nga Shqipëria nëpërmjet zgjerimit të rrjetit kryesor TEN-T, që mbërrin në Portin e Durrësit ose që del nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Si pjesë e agjendës së ndërlidhjes, projekti synon të lidhë nëpërmjet hekurudhës Shqipërinë me Malin e Zi nëpërmjet Tuzit/Podgoricës, e cila më tutje synon të zhvillohet me vendosjen e një lidhjeje hekurudhore ndërkombëtare ndërmjet kryeqyteteve kryesore, duke përfshirë, përveç Tiranës e Podgoricës edhe Beogradin, Zagrebin, Lubjanën dhe Budapestin e do të japë një shtysë në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit.

Ndërkohë, sqarojmë se projektligji mbështetet në Strategjinë Sektoriale të Transportit 2016-2020, ku, referuar politikave dhe planit të veprimit, ka si qëllim

prioritar për transportin hekurudhor, përfundimin dhe modernizimin e rrjetit hekurudhor shqiptar, në përputhje me standardet e rrjetit TEN-T.

Zbatimi i projektit synon:

- rritjen e kushteve të sigurisë dhe shpejtësisë së trenave përgjatë kësaj linje hekurudhore;
- ndërtimin e një infrastrukture hekurudhore ndërvepruese, të lidhur me vendet fqinje të rajonit e më gjerë, që plotëson kërkesat e Sistemit Evropian të Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor (ERTMS);
- krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e shërbimeve të udhëtarëve dhe mallrave;
- rritjen ekonomike dhe zhvillimin social brenda vendit;
- lehtësimin e lidhjeve tregtare dhe ekonomike me vendet fqinje dhe ato anëtare të BE-së;
- përmirësimin e kapacitetit të transportit;
- zhvillimin e një transporti të qëndrueshëm, multimodal dhe intermodal në Shqipëri, në rajon e më gjerë, në përputhje me politikat e zhvillimit të transportit të shtetit shqiptar;
- promovimin e transportit të gjelbër dhe të qëndrueshëm dhe nxitjen për kalimin nga transporti rrugor në transportin hekurudhor, duke promovuar një alternativë më eficiente për komunitetin dhe bizneset.

Projekti konsiston në përmirësimin e linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi), duke rritur shpejtësinë e lëvizjes së trenave deri në 120 km/orë në një linjë hekurudhore të elektrifikuar, sipas kategorisë UIC D4, 22.5 ton/aks dhe 8.0 ton/m, prej rreth 120 km. Projekti parashikon ndërtimin e 12 stacioneve hekurudhore, ndërtimin e një tuneli me gjatësi 320 metër, ndërtimin e 12 urave etj. Me ndërtimin e kësaj linje hekurudhore pritet një fluks udhëtarësh prej 2 300 000 udhëtarësh/vit dhe volum mallrash prej 900 000 tonësh/vit. Koha mesatare e udhëtimit nga Vora në Hanin e Hotit pritet të jetë 2 orë.

Për zbatimin efektiv të projektit, Hekurudha Shqiptare ka ngritur një njësi për zbatimin e projekteve (NJZP – PIU), e cila është inkorporuar në strukturën organizative të miratuar të shoqërisë, sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës. Njësia për zbatimin e projekteve është përgjegjëse për të gjitha projektet e zhvillimit të hekurudhave në Shqipëri dhe mbështetet nga stafi i përhershëm i Hekurudhës Shqiptare dhe nga ekspertë, që do të sigurohen përmes asistencave teknike të donatorëve.

Referuar planit të prokurimit, procesi i prokurimit për projektin hekurudhor Vorë – Hani i Hotit është parashikuar të vazhdojë deri më dhjetor 2024, me nënshkrimin e kontratës së punimeve, e cila vijon me zbatimin e punimeve në

fund të vitit 2024 (dhjetor 2024) dhe përfundon në dhjetor 2030, me një afat zbatimi prej 6 vjetësh.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në harmoni me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.95, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar midis palëve. Në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, ajo do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për rehabilitimin e linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit.

Marrëveshja i bashkëlidhet projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Financave.

Agjencia zbatuese e projektit është Hekurudha Shqiptare.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar dhe propozuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi i këtij projekti është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe më konkretisht në programin “Transporti hekurudhor” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Huaja ka termat financiarë të mëposhtëm:

- Shuma e huas: 98 750 000 euro, e cila ndahet në dy transhe:
(një transh i angazhuar prej 84 500 000 euro, si dhe një transh i paangazhuar prej 14 250 000 eurosh, i cili do të angazhohet pas plotësimit të një sërë kushtesh të parashikuara në marrëveshje);
- Interesi: Bazuar në normë të ndryshueshme interesi;
- Tarifa *front-end*: 1% e shumës së principalit;
- Tarifa e angazhimit: 0.5% në vit;
- Maturimi: 17 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh, pa pagesë principal.

KËSHILLI I MINISTRAVE